



Prishtinë: 27.12.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1219_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1996_11_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **19.12.2019**.

në seancën e mbajtur më datë **27.12.2019**, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin S.K. (parashtruesi N.D.) nga Prizreni, me shifër të konsumatorit **DPZ – 11089** si e pa bazuar.
- II **MBETET** në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1996_11_19** i datës 15.11.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 19.12.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Agjencia Kosovare e Pronës me datë 08.07.2009 i ka lëshuar S.K. protokollin mbi dorëzimin e çelësave për banesën “Beteja e Llapushinkut 7/9, nr. 29, Prizren dhe se bazuar në këtë protokoll dhe Udhëzimin Administrativ Nr.06/2017 është bërë kontestimi i borxhit prej -1820.35€. Në ankesë theksohet se konsumatori S.K. me datë 29.12.2009 për shkak të pamundësisë të shfrytëzimit të banesës ka parashtruar padi në gjykatë, por që gjykata është shpallur jo kompetente dhe se lënda i është dorëzuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe se gjykata nuk ka marrë ende vendim të formës së prerë. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1996_11_19 të datës 15.11.2019 për konsumatorin S.K. me shifër DPZ - 11089.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkalës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se bazuar në protokollin e Agjencisë Kosovare të Pronës të datës 08.07.2009 i është bërë kontestimi i borxhit në vlerë prej -1,820.35€ dhe kjo bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.06/2017, Bordi i ZRRE-së thekson se është plotësisht e saktë se



Agjencia Kosovare e Pronës me datë 08.07.2009 i ka lëshuar Protokollin mbi dorëzimin e çelësave S. K. për banesën me adresë “Beteja e Llapushnikut 7/6, nr.29, Prizren. Bordi i ZRRE ka analizuar edhe shkresën e Agjencionit Kosovar të Pronës e datës 29.10.2018, dhe ku theksohet se prona me adresë Rr: “Eqrem Qabej” Ort.7/6, nr.29, Prizren ka qenë në shfrytëzim nga M.B. – B.M. brenda periudhës 2000 – 2009, dhe se përmes vendimit të komisionit të KPCC e kthyer pronën në riposedim të pronarit të ligjshëm i cili ka pranuar çelësat e pronës dhe ka nënshkruar Protokollin e dorëzimit të çelësave me datës 08.07.2009. Mirëpo gjithashtu Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në shkresat e lëndës ka vërejtur se S.K. pasi që nuk ka mundur të shfrytëzoj banesën në fjalë, me datë 29.12.2009 ka bërë padi në Gjykatën Komunale në Prizren C.nr.1041/09 me kërkesëpadi për realizimin e kontratës së shitblerjes dhe dorëzimin e banesës, por që Gjykata Komunale në Prizren është shpallur jokompetente dhe lënda i është dorëzuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Bordi i ZRRE pas analizimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se S.K. i është drejtuar Agjencionit Kosovar të Privatizimit, Komisionit për shitjen e banesave, me kërkesë për blerjen e serishme të banesës së njëjtë. Agjencia Kosovare e Privatizimit përmes drejtorit Menaxhues E.H. duke vepruar në emër të NSH “Liria”, Prizren, e në cilësinë e shitësit, me datë 27.09.2018 ka nënshkruar Kontratë për Shitblerjen e Banesës me blerësin S.K.

Bordi i ZRRE gjatë analizave të bëra shkresave të lëndës ka analizuar edhe disa procesverbale të Themelore në Prizren. Bordi i ZRRE ka vërejtur se procesverbalin e Gjykatës Themelore në Prizren CN.nr.501/18 të datës 11.12.2018, gjykata ka nxjerr një Aktvendim me të cilën ka aprovuar kërkesën e propozuesit për sigurimin e provave përmes angazhimit të ekspertëve të energjisë elektrike dhe të ujësjellësit dhe është shtyrë seanca për një datë tjetër. Gjithashtu në procesverbalin tjetër të gjykatës të datës 11.12.2018 gjykata ka nxjerr një Aktvendim ku ka obliguar ekspertët për energji elektrike dhe për ujësjellës që në afat prej 3 ditëve t’i përgatisin raportet e tyre me shkrim lidhur me këtë çështje. Pas kësaj Gjykata me datë 19.12.2018 ka përpiluar edhe një procesverbal me të cilën është konstatuar se ekspertët e energjisë elektrike dhe të ujësjellësit me kohë kanë dorëzuar raportet dhe skicat me shkrim nga vendi i ngjarjes së datës 12 dhe 13.12.2018 dhe pjesë e këtij procesverbali janë edhe ekspertiza e ekspertëve të energjisë elektrike dhe të ujësjellësit. Në raportin “Ekspertizë - Sigurimi i provave” i përpiluar në dhjetor 2018 nga ekspertët e të energjisë elektrike dhe të ujësjellësit për Gjykatën Themelore në Prizren është konstatuar se banesa në rrugën Ortakoll rruga Eqrem Qabej Llamella VII/6 hyrja I kati 5, banesa nr.29 është pa energji elektrike dhe se është ndërprerë në tabelën elektrike ku gjenden edhe njehsorët tjerë. Banesa posedon njehsorin elektrik nr.63986890 dhe është i montuar në hyrje të ndërtesës në anën e majtë siç shihet në foto, dhe njehsori ka shifrën 11089 në emër të konsumatorit K.S. dhe me gjendje TL=5681 kWh dhe TU=3575 kWh. Në raport është theksuar se në bazë të transaksioneve të konsumatorit qysh nga tetori i vitit 2002 e deri më nëntor 2018 energjia elektrike është lexuar dhe faturuar rregullisht dhe se borxhi i energjisë elektrike deri në muajin nëntor 2018 është 6,975.72€. Pra Bordi i ZRRE-së thekson se po që se konsumatori do ta kishte shfrytëzuar pas protokollit të dorëzimit të çelësave të datës 08.07.2009 banesën në fjalë, atëherë konsumatori nuk do të paraqiste padi në gjykatë për shfrytëzim të banesës, e as gjykata nuk do të angazhonte ekspertë për të vërtetuar gjendjen e energjisë elektrike në banesë, si dhe nuk do të paraqiste kërkesë te Agjencioni Kosovar i Privatizimit për blerjen e serishme të banesës së njëjtë, e që Agjencia Kosovare e Privatizimit me datë 27.09.2018 ka nënshkruar Kontratë për Shitblerjen e Banesës me blerësin S.K.

Bordi i ZRRE ka analizuar edhe Kontratën mbi shitblerjen e patundshmërisë të nënshkruar me datë 04.02.2019 te Noteri në mes të shitësit S.K. dhe blerësit N.D. dhe ke vërejtur se sipas pikës 5 të kësaj kontrate theksohet se: *“Palët bien dakord që shitësi është i detyruar të paguajë të gjitha faturat me energji elektrike të konsumuar, ujë, mbledhjen e mbeturinave, tatimin, si dhe të gjitha detyrimet e tjera që rëndojnë mbi pasurinë e paluajtshme – apartamentit, deri në ditën e përdorimit (dorëzimit të blerësit) të pronës në fjalë – apartamentin”*. Pra nga kjo shihet qartë se blerësi i ri Nuhi Daka bazuar



në kontratën e shitblerës së pronës, pronar legjitim është nga data 04.02.2019 dhe se obligimet e tij rrjedhin nga data e përcaktuar në kontratë.

Bordi i ZRRE thekson se sipas nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*. Gjithashtu neni 5 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“furnizuesi duhet të faturojë dhe të arkëtojë (mbledh) pagesat prej konsumatorëve”*, andaj në këtë rast furnizuesi nuk ka vepruar konform kësaj dispozite pasi që nuk ka arrit të inkasoj borxhin e krijuar ashtu siç përcaktohet me këtë rregull.

Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë me të cilën ke obliguar KESCO që ta shkarkoj konsumatorin nga borxhi i energjisë elektrike deri më datën 27.09.2018 (Kontratën për shitblerjen e banesës nr.7279 të datës 27.09.2018 të nënshkruar në mes Agjencia Kosovare e Privatizimit përmes drejtorit Menaxhues E.H. duke vepruar në emër të NSH “Liria”, Prizren, e në cilësinë e shitësit, dhe blerësit S.K.), është i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë me të cilën ke obliguar KESCO që borxhin e krijuar në shifrën DPZ – 11089 deri më datën e lartcekur ta kërkoj përmes procedurave gjyqësore, nga personat që e kanë krijuar, është vendim plotësisht i drejtë.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit S.K. (parashtruesi N.D.) dhe
- Arkivit të ZRRE-së.